

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR AUTORIZIMIN E AGJENCISË SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN PËR NEGOCIIMIN E AFATIT TË SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË NEVOJSHME PËR NDËRTIMIN E SPITALIT TË FIERIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i aktit normativ “Për autorizimin e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin për negociimin e afatit të shpronësimit të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të nevojshme për ndërtimin e spitalit të Fierit”, propozuar nga Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë është autorizimi i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin për negociimin e afatit të shpronësimit të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të nevojshme për ndërtimin e spitalit të Fierit.

Ky akt normativ është i domosdoshëm për krijimin e kushteve për fillimin e punimeve të spitalit të Fierit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Në këndvështrim të programit politik të Këshillit të Ministrave, ky akt normativ përshtatet me objektivat e krijimit të kushteve për realizimin e investimit, për kryerjen e punimeve të spitalit të Fierit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky akt normativ do të hapë rrugë për autorizimin e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin për negociimin e afatit të shpronësimit të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të nevojshme për ndërtimin e spitalit të Fierit.

Ky akt normativ është i domosdoshëm për krijimin e kushteve për fillimin e punimeve të spitalit të Fierit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Për sa i përket çështjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit normativ, nga pikëpamja formale, ai mbështetet në nenin 101 të Kushtetutës, i cili parashikon se:

Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 (pesë) ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky akt normativ nuk synon përafrimin e ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Neni 1 përcakton autorizimin e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin që të negociojë dhe të nënshkruajë marrëveshje me pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të nevojshme për spitalin e Fierit.

Neni 2 parashikon se marrëveshja përcakton të drejtën e përdorimit menjëherë të pasurisë së paluajtshme, pronë private, para përfundimit të procedurës së shpronësimit.

Neni 3 përcakton se çdo pronar shpronësohet në përputhje me çmimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 4 përcakton se nënshkrimi i marrëveshjes së përcaktuar në pikën 1, të këtij akti normativ, nuk pengon pronarët për kundërshtimin në rrugë gjyqësore të çmimit të shpronësimit.

Neni 5 përcakton se ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij akti normativ.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky akt normativ është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin, si dhe mbështetur në kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Akti normativ nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE